



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



z. Azem BUJUPI
Drejtore
Radio KOSOVA 1 dhe
Radio KOSOVA 2
Sheshi Nëna Terezë, p.n.
Prishtinë

Ref: 1608/882 /LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio KOSOVA 1 dhe Radio KOSOVA 2 – Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio me mbulim nacional, të cilat janë të licencuara licencuar për të transmetuar radio programe në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më 28 gusht 2009, Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së.
3. Më 19 korrik 2016, Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit nga pika e transmetimit në Objektin e RTK-Radio VUSH, për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të kaluar me transmetim në pikën e transmetimit në Vneshta.
4. Arsyetimi i drejtorit të Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, mbështetet në rinovimin e teknologjisë së transmetimit në brezin FM.

5. Më datë 25 korrik 2016, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka vizituar pikën e licencuar dhe pikën e propozuar për vendosjen e transmetuesit të Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, për të vlerësuar gjendjen faktike në terren me të cilin rastë ka bërë matjet kenike si dhe analizën e rezultateve lidhur kërkesës për ndryshimin e lokacionit të transmetimit.

Arsyetim


6. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*
7. Gjithashtu, neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2 thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
8. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, Komisioni konstaton se, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, për të zhvendosur sistemin e transmetimit nga pika e transmetimit në objektin e RTK-Radio VUSH, për ku janë të licencuar për të transmetuar sipas licencës, në koordinatat N 42° 39' 28" E 21° 09' 40" për të kaluar me transmetim në pikën e transmetimit në Vneshta në koordinatat N 42° 40' 20" E 21° 10' 52" nuk do të ketë ndryshime në zonën e mbulimit prej asaj të licencuar.

VENDIM

Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 8 shtator 2016, merrë vendim për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit të Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 nga pika e transmetimit në objektin e RTK-Radio VUSH, për ku janë të licencuar për të transmetuar sipas licencës, dhe kalimin në pikën e transmetimit në Vneshta, sipas koordinatave të lartpërmendura

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



08.09.2016

datë